



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 14.5.2019

*Dokument parlamentar
(Komision përgjegjës)*

RAPORT

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK (KPP) PËR VITIN 2018

Komisioni për Ekonominë dhe Financat në mbledhjet e datave 06 dhe 14 Maj 2019, zhvilloi seancën dëgjimore për shqyrtimin e Raportit vjetor të veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik, për vitin 2018 si dhe miratoi projektrezolutën përkatëse.

Komisioni e shqyrton raportin në përputhje me kalendarin e punimeve të tij, si dhe në zbatim të nenit 19/9, të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 103, të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë dhe vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.134/2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”.

Në mbledhjen e Komisionit ishte e pranishme Kryetarja e Komisionit të Prokurimit Publik Znj. Evis Shurdha dhe përfaqësues të tjerë të Komisionit të Prokurimit Publik.

Kryetarja e Komisionit të Prokurimit Publik në fjalën e saj paraqiti drejtimit kryesore të veprimtarisë së institucionit gjatë vitit të mëparshëm si dhe prioritetet kryesore të tij për vitin 2019.

Relatorja, e caktuar nga Komisioni për këtë çështje znj. Blerina Gjylameti, paraqiti një informacion me vlerësimet e saj për veprimtarinë njëvjeçare të këtij institucioni si dhe rekomandimet për përmirësimin e punës gjatë vitit në vazhdim.

Raporti vjetor, pasqyron në mënyrë të detajuar të gjithë aktivitetin e Komisionit të Prokurimit Publik përfshi numrin total të ankesave të trajtuara nga institucioni, numrin e vendimeve të marra nga ky i fundit si dhe një vlerësim statistikor të përgjithshëm lidhur me shpërndarjen e ketyre ankesave, raport ekonomiko- financiar, informacion për proceset gjyqësore ku janë ankimuar vendimet e KPP, si dhe objektivat për vitin 2019.

Veprimtaria e KPP-së gjatë vitit 2018 rezulton me një volum të konsiderueshëm shqyrtimesh ankimore si dhe në kryerjen e detyrave funksionale në ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Gjithashtu është miratuar rregullorja e funksionimit të brendshëm të institucionit. Rezulton se janë përmbushur pjesërisht rekomandimet e rezolutës së Kuvendit.

Në mbledhjen e datës 14 maj, Komisioni u mbledh për një seancë pyetje-përgjigje në të cilën Kryetarja e Komisionit të Prokurimit Publik iu përgjigj pyetjeve të deputetëve të pranishëm.

Në këtë mbledhje u shqyrtua dhe draft Projekt- Rezoluta e përgatitur nga Relatorja, e cila pasqyron të dhënat e raportuara për aktivitetin e KPP-së, si dhe çështjet e diskutuara në seancën dëgjimore të datës 06 maj. Projekt- Rezoluta paraqet vlerësimet për veprimtarinë e KPP-së gjatë vitit 2018 si dhe rekomandimet përkatëse për vitin 2019.

Nëpërfundim të mbledhjes, Komisioni miratoi Projekt- Rezolutën me votat pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje dhe ia paraqit për miratim Kuvendit sipas variantit që i bashkëlidhet këtij raporti.

RELATOR

KRYETAR

Blerina GJYLAMETI

Arben AHMETAJ

KUVENDI I SHQIPËRISË

Tiranë, më _____.2019

Dokument parlamentar

PROJEKTREZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK (KPP) PËR VITIN 2018

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

Duke njohur Komisionin e Prokurimit Publik si organin më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm për KPP paanësinë në vendimmarrje, transparencën, efikasitetin si dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë nga veprimet apo mosveprimet e autoriteteve kontraktore dhe në mënyrë të veçantë mbrojtjen e interesit publik.

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm rolin që KPP ka në rritjen e efikasitetit dhe të besueshmërisë në sistemin e prokurimit publik.

Duke vlerësuar hapat e rëndësishëm që janë ndërmarrë për rritjen e pavarësisë institucionale të KPP, përmes ndryshimeve të fundit ligjore.

Vlerëson veprimtarinë e Komisionit për vitin 2018 në drejtim të:

- Miratimin e rregullave të hollësishme të procedurave, sic është dhe rregullorja e brendshme për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të KPP-së, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në efektivitetin dhe performancën e institucionit.
- Dhënien e asistencës së nevojshme ligjore në lidhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi që prekin procedurat e prokurimit, koncensionet/ppp, ankandet e lejet minerare.
- Bashkëpunimin e vazhdueshëm me institucionet partnere ndërkombëtare kryesisht i orientuar në organizimin e disa trajnimeve dhe aktivitete të shkëmbimit të eksperiencave me synim rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të KPP-së, në lidhje me zhvillimet më të reja në mekanizmat e rishikimit administrativ të prokurimit publik në vendet e BE-së, si dhe rajon, si edhe me mënyrat dhe metodat më të mira të menaxhimit të institucioneve homologe.
- Rritjen e të ardhurave të derdhura në buxhetin e shtetit nga tarifat e ankimimit të operatorëve ekonomik për të cilët në fund të procesit administrativ është vendosur mos pranimi i ankesës së tyre.

Kuvendi kërkon që Komisioni për vitin 2019, të përmirësoj punën në këto drejtime:

- Për të gjitha rastet e anulimit të vendimeve të Autoriteteve Kontraktore, të marrë masa, sipas natyrës së shkeljes së konstatuar, duke i referuar autoritetit përkatës, APP për kundravajtje administrative dhe prokurorisë për shkelje penale.
- Të marrë masa për standartizimin e vendimarrjes dhe bërjen publike të tyre me qëllim rritjen e efikasitetit të shqyrtimit të çështjeve, garantimin e barazisë si dhe sigurimin e transparencës.
- Të publikohet në faqen web të insitucionit në fund të cdo vitit lista e procedurave ankimese të cilat janë ose ka përfunduar procesi gjyqësor, fondet limite të këtyre procedurave objekt ankimi.
- Të rritet bashkëpunimi me Gjykatën Administrative përsa i takon trajnimit të punonjësve të të dy institucioneve me qëllim aftësimin e tyre për të trajtuar çështje komplekse të prokurimit publik dhe për tu përballuar me numrin në rritje të ankimimeve, në zbatim të rekomandimeve të lëna në Progres Raport.
- Të forcohen kapacitetet administrative të KPP-së duke e bërë totalisht funksionale strukturën e miratuar nga Kuvendi, deri në fund të vitit 2019.
- Të bëhet transparente në vendimet e publikuara nga KPP edhe procesi i votimit të anëtarëve të Komisionit si dhe rastet e përjashtimit gjatë procesit të shqyrtimit ankimor të ndonjërit prej anëtarëve.
- Të plotësohet Regjistri Elektronik i Ankesave me elementët shtesë të nevojshme siç janë edhe dokumentacioni shoqërues i ankesës së Operatorit Ekonomik dhe vendimi i gjykatës nëse çështja ka kaluar për gjykim.